



11-12-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Nr./Br. 2545-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, nenin 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 11.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.SHPETIM HAJREDINI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Dragash, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Shaban Shabani**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Shpetim Hajredini**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 08.12.2017, nr.2518/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Shaban Shabani, pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye se është zgjedh kryetar i komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Shpetim Hajredini, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 11.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

